



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në përputhje me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike, Ligjin për Buxhet të Republikës së Kosovës dhe Qarkoreve Buxhetore 2018 - 01/02 të pranuar nga Ministria e Financave, Komuna e Gjakovës nga data 04.09.2017 deri me datën 11.09.2017 nën patronatin e Kuvendit Komunal të Gjakovës ka organizuar serinë e dëgjimeve Buxhetore me publikun në të gjitha rajonet e Komunës.

**RAPORT**

I dëgjimeve publike për Buxhetin e vitit 2018-2020 të komunës së Gjakovës me qytetarët e Komunës së Gjakovës,

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa - Teki Shala gjatë dëgjimeve buxhetore prezantoi buxhetin e ndarë për Komunën e Gjakovës, ku theksoi se buxheti i paraparë për vitin 2018 është 22,797,637.00 € që nënkupton se ka rritje në vlerën prej 1,567,788.00 € krahasuar me vitin aktual 2017. Teki Shala potencoi burimet e financimit si dhe pjesëmarrjen e secilës kategori të shpenzimeve në buxhetin e planifikuar.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa prezantoi tek të pranishmit edhe listën e projekteve kapitale të planifikuara për vitet 2018 – 2020.

**1.Dëgjimet Buxhetore me Publikun në Skivjan,**

**Datë: 04.09.2017, ora 16:00**

**Banorët e Skivjanit kërkuan që :**

Qendra Sekondare Skivjan të realizohet si projekt, të realizohet një projekt për kanalizimet e ujërave të zeza dhe atmosferike, sidomos tek lagjja Fetahaj, pasi që ende nuk është rregulluar kjo çështje. Kërkuan edhe realizimin e një projekti që përfshinë rrugën me gjatësi prej 800 metrave që lidh 25 shtepi. Kërkuan edhe mirëmbajtjen e ndriqimit publik pasi që është dëmtuar në masë.

Pjesëmarrësit thanë që në Dobrigje është ndërtuar rruga mirëpo shkolla nuk është e lidhur me rrugë. Patën kërkesa që të ndërtohen 4 kanale për bujqësi dhe 1 fushë sporti në Dobrigje.

Për shkollën e Skivjanit kërkuan ndërtimin e kulmit të shkollës, kërkuan ndërhyrje në rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza, ndërtimin e trotuarit rrugorë deri tek fshati Planqor.

Kërkuan që Komuna të parasheh investime edhe në Osek Hylë dhe shtrimin e shtresës së dytë të asfaltit në Skivjan. Hereqi poashtu sipas pjesëmarrësve duhet të përfshihet në listë të projekteve, aty ka nevojë për trotuare dhe ndërtim të rrugës së UÇK-së.

Foli Drejtori i Buxhetit dhe Financave z.Teki Shala duke ju sqaruar pjesëmarrësve që çdo kërkesë e tyre ishte me vend mirëpo si rezultat i buxhetit të kufizuar nuk mund të merren të gjitha në konsideratë. Z.Basri Komoni – Drejtori i Shëndetësisë gjithashtu prezantoi projektet e Shëndetësisë. Përveç tyre në diskutim foli edhe Drejtori i Bujqësisë z. Bekim Ermeni që i njoftoi banorët lidhur me projektet e Drejtorisë së Bujqësisë dhe aktivitet që kjo drejtori parasheh të mbajë. z. Ermeni

potençoi dhe bëri thirrje për banorët pjesëmarrës që të aplikojnë për të përfituar subvencione, të përfitojnë fidanë, lopë dhe të tjera që ndihmojnë veprimtarinë e rregullt të buqëve.

Lidhur me projektet shëndetësore diskutoi dhe Drejtori i Shëndetësisë z. Basri Komoni që u ndal më tepër tek Projekti i Renovimit të Objekteve Shëndetësore, ku ju premtoi banorëve që do të merret në Konsideratë edhe qendra e mjekësisë familjare e rajonit të tyre.

Znj. Kaltrina Biblekaj – Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Publike theksoi që rruga në Dobrigje do të asfaltohet deri te rruga që lidhet me shkollën.

Znj. Hana Zeka – Drejtore e Inspeksionit u tha pjesëmarrësve që për kioske dhe mbeturina do angazhohen inspektorët të dalin në teren për të verifikuar situatën dhe për ti ndërmarrë procedurat e rregullta ligjore.

## **2.Dëgjimet Buxhetore me Publikun në Novosellë,**

**Datë: 04.09.2017, ora 18:00**

### **Banorët e Novosellës kërkuan që :**

Të shtrohen trotualet e rrugës që të dërgon tek shkolla. Të investohet në ndriçim publik pasi që rrjeti elektrik është shumë i dobët. Të investohet në shkollën fillore pasi që nuk posedon tualete. Të rregullohet ura në fshatin Trakaniq pasi që është dëmtuar. Pjesëmarrësit thanë që shumë lagje kanë probleme me rrymë. Patën pyetje edhe rreth programit të Shëndetësisë, ku kërkuan që të ofrohet leje për objektin e Mjekësisë Familjare ose të ofrohet zyre.

Fjalën e morri z.Basri Komoni që ua theksoi pjesëmarrësve që duhet të posedohet leje për ndërtim të objektit të Mjekësisë Familjare ndërkaq ky projekt duhet të dedikohet për qëllime tjera.

Znj. Kaltrina Biblekaj iu premtoi që rreth dëmtimit të urës së Trakaniqit do të dërgohet komisioni në teren për ta shqyrtuar. Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa ju potençoi atyre që shumë projekte me vlerë madhore varen edhe nga Ministria, kështu që së shpejti do fillojnë edhe punimet në rrugën Skivjan – Novosellë pasi që është projekt që financohet nga Ministria e Infrastrukturës.

## **3.Dëgjimet Buxhetore me Publikun në Bec,**

**Datë: 05.09.2017, ora 16:00**

### **Banorët e Becit kërkuan që :**

Komuna të investojë në përmirësimin e rrjetit të kanalizimit pasi që në rast të reshjeve atmosferike përmblyten shtëpitë, ndërtimin e urave, përmirësimin e rrjetit të ndriçimit publik – të ushtrohet presion tek operatorët e pa përgjegjshëm. Banorët kërkuan që Rruga në Lugëbunar dhe Rruga tek Tyrbja Bec të përshpejtohet dhe jo të ndahet ndërtimi i tyre në vite. Përveç tjerash kërkuan edhe mirëmbajtjen e Rrugës Shqiponjë – Gjakovë, e cila sipas tyre nuk është mirëmbajtur që sa vite.

Në këtë diskutim morri fjalën edhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike znj. Kaltrina Biblekaj që iu përgjigj banorëve në pyetjet që kishin lidhur me projektet e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe iu premtoj që në projektet e nisura për të cilat operatorët janë përgjegjës do të ushtrojë presion që të përfundohen. Përveç tyre në diskutim foli edhe Drejtori i Bujqësisë z. Bekim Ermeni që i njoftoi banorët lidhur me projektet e Drejtorisë së Bujqësisë dhe aktivitet që kjo drejtori parasheh të mbajë. z. Ermeni potençoi dhe bëri thirrje për banorët pjesëmarrës që të aplikojnë për të përfituar subvencione, të përfitojnë fidanë, lopë dhe të tjera që ndihmojnë veprimtarinë e rregullt të buqëve. Lidhur me projektet shëndetësore diskutoi dhe Drejtori i Shëndetësisë z. Basri Komoni që u ndal më tepër tek Projekti i Renovimit të Objekteve Shëndetësore, ku ju premtoi banorëve që do të merret në Konsideratë edhe qendra e mjekësisë familjare e rajonit të tyre.

## **4.Dëgjimet Buxhetore me Publikun në Cërmjan,**

**Datë: 05.09.2017, ora 18:00**

### **Banorët e Cërmjanit kërkuan që :**

Cërmjani të mirret në konsiderat dhe të mos shtyhen projektet nga viti në vit, për shkak që nevojat e këtyre banorëve janë prioritete sepse gjendja e banorëve është në rrezik si rezultat i kanalizimeve dhe ujërave të zeza sidomos tek Varrezat e lagjes Hoxha. Të përfundohet rruga në Meqë dhe në

Rashkoc. Të renovohet shkolla në Meqë pasi që gjendja e saj është e mjerueshme. Banorët thanë që paguajnë rregullisht taksat komunale dhe përkundër këti fakti meritojnë benefite. Përmendën gjithashtu Shtëpinë e Kulturës – Projekt ky që bartet nga viti në vit që 4 vite, kërkuan që të përfundojë ky projekt. Qendra e Mjekësis Familjare ende nuk është rinovuar, as pajisjet mjeksore që janë premtuar aty nuk kanë ardhur asnjëherë. Banorët e rajonit kërkuan edhe një mbi kalim për rrugën magjistrale pasi që fëmijët i ekspozohen rrezikut nga lëvizja e shpejtë e makinave ose në të kundërtën të vendosen policë të shtrirë në këtë rrugë.

Një banorë i Cermjanit potencoi që në faturat e tatimit në pronë kishtë një ngarkesë të tepërt për banorët e fshatit si rezultat i ngatërresës së zonës tatimore, gjë për të cilën Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa premtoi se do të marr masa.

Banorët e rajonit të Cermjanit patën shumë kërkesa, për disa nga të cilat u premtua se do të ketë investime. Në këtë diskutim morri fjalën edhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike znj. Kaltrina Biblekaj që iu përgjigj banorëve në pyetjet që kishin lidhur me projektet e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe iu premtoj që në projektet e nisura për të cilat operatorët janë përgjegjës do të ushtrojë presion që të përfundohen. Znj. Biblekaj tha se në projektin e kanalizimit të ujërave të zeza nuk do të përfshihet këtë herë Cermjani, pasi ky projekt iu dedikohet mirëmbajtjes së rajoneve tjera. Përveç tyre në diskutim foli edhe Drejtori i Bujqësisë z. Bekim Ermeni që i njoftoi banorët lidhur me projektet e Drejtorisë së Bujqësisë dhe aktivitetet që kjo drejtori parasheh të mbajë.

z. Ermeni potencoi dhe bëri thirrje për banorët pjesëmarrës që të aplikojnë për të përfituar subvencione, të përfitojnë fidane, lopë dhe të tjera që ndihmojnë veprimtarinë e rregullt të buqëve. Lidhur me projektet shëndetësore diskutoi dhe Drejtori i Shëndetësisë z. Basri Komoni që u ndal më tepër tek Projekti i Renovimit të Objekteve Shëndetësore, ku ju premtoi banorëve që do të mirret në Konsideratë edhe qendra e mjekësisë familjare e rajonit të tyre.

#### **5. Dëgjimet Buxhetore me Publikun në Molliq,**

**Datë: 06.09.2017, ora 16:00**

#### **Banorët e Molliqit kërkuan që :**

Edhe Botusha të përfshihet në listën e projekteve kapitale për 3 vitet e ardhshme, pasi banorët e këtij rajoni janë shumë të rregullt në pagesën e taksave dhe presin Benefite si dëmshpërblim.

Banorët përmendën projektin “Ndërtimi i rrugës në fsh. Botushë” projekti i paraparë për vitin 2017, i cili ende nuk ka përfunduar, banorët e interesuar pyetën se çfarë ka ndodhur me ato para, ndërkohë që Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike iu kundërpërgjigj me faktin që paratë e dedikuara nuk do të humbin mirëpo ai projekt do të përfundojë këtë vit.

Banorët e këtij rajoni falënderuan për projektin e Bujqësisë – “Qendra Grumbulluese e Qumështit” projekt që është përfunduar me sukses mirëpo pyetën edhe për projektin “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes” që ende nuk është përfunduar, mirëpo Drejtori i Bujqësisë z. Ermeni iu kundërpërgjigje që gjithë procedurat janë të gatshme duhet vetëm të ushtrohet presion tek operatorët.

Kërkesë tjetër e tyre ishte edhe “Ndërtimi i rrugës Smajl Isen” – Aneksi i 4 (700 metra), ata potencuan se kjo rrugë është me rëndësi vitale pasi që është rruga kryesore që lidh tërë rajonin. Drejtori i Drejtorisë për Buxhet ju premtoi këtyre banorëve që kjo rrugë do të merret parasysh dhe do të përfshihet në listë të projekteve për vitin 2018. Drejtori i Bujqësisë gjithashtu ju sqaroi që 300 metra të kanalit të ujitjes do hapen sivjet ndërkaq edhe 700 metra në vitin 2018. Banorët e rajonit të Molliqit nuk u ndalën me kërkesa, kërkuan më shumë investime edhe në Nivokaz, mirëpo Drejtorët theksuan më tutje që buxheti është i kufizuar dhe me buxhetin që kanë po përpiqen në mënyrë proporcionale të ndajnë projekte.

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike znj. Kaltrina Biblekaj që iu përgjigj banorëve në pyetjet që kishin lidhur me projektet e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe iu premtoj që në projektet e nisura për të cilat operatorët janë përgjegjës do të ushtrojë presion që të përfundohen.

Përveç tjerash Drejtori i Bujqësisë z. Bekim Ermeni që i njoftoi banorët lidhur me projektet e Drejtorisë së Bujqësisë dhe aktivitet që kjo drejtori parasheh të mbajë.

z. Ermeni potencoi dhe bëri thirrje për banorët pjesëmarrës që të aplikojnë për të përfituar subvencione, të përfitojnë fidane, lopë dhe të tjera që ndihmojnë veprimtarinë e rregullt të buqëve.

#### **6.Dëgjimet Buxhetore me Publikun në Sherehmet – Rracaj, Datë: 06.09.2017, ora 18:00**

##### **Banorët e Sherehmetit kërkuar që :**

Të sigurohet transporti për fëmijët që shkojnë në shkollë, kërkuar gjithashtu që Komuna të investojë në asfaltimin e rrugëve dhe në rrjetin e kanalizimit, pasi që era e keqe dhe ujërat e zeza janë rrezik që shkaktojnë epidemi të ndryshme.

Banorët thanë që ky rajon përfshinë 5 fshatra dhe rrugët në këto fshatra janë pjesërisht të asfaltuara, kështu që kërkuar që rrugët të asfaltohen komplet.

Kërkuar që të shtrohen trotualet në rrugën Dobrosh – Rracaj pasi që këmbësoret rrezikohen të ecin. Ky rajon përkundër kërkesave jo shumë të mëdha për rrugë kishte kërkesa më të mëdha për kanale të ujitjes. Ata i kërkuar Drejtorit të Bujqësisë që të hap më shumë kanale të ujitjes pasi që ky rajon ka një konfiguracion më të mirë të ujit në të cilin duhet të investohet.

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike znj. Kaltrina Biblekaj që iu përgjigj banorëve në pyetjet që kishin lidhur me projektet e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe iu premtoj që në projektet e nisura për të cilat operatorët janë përgjegjës do të ushtrojë presion që të përfundohen. Si dhe u tha që projektet e parapara për vitin 2017 do të realizohen këtë vit, si p.sh projekti në fshatin Rracaj që vetëm ka për ta ekzekutuar kompania pasi që procedurat tjera janë përfunduar. Z. Biblekaj premtoj se do të interesohet edhe për projektet tjera të parapara për tu realizuar në vitin 2017.

Fjalën e morri edhe Z.Ermeni – Drejtori i Bujqësisë që iu tha banorëve se do të hapet kanali i ujitjes edhe 700 metra në vitin 2018 në këtë rajon, gjë që nënkupton se një pjesë dërmuese e buxhetit të paraparë për kanale të ujitjes do i dedikohet këtij rajoni. Përveç tjerash Drejtori i Bujqësisë z. Bekim Ermeni që i njoftoi banorët lidhur me projektet e Drejtorisë së Bujqësisë dhe aktivitet që kjo drejtori parasheh të mbajë.

z. Ermeni potencoi dhe bëri thirrje për banorët pjesëmarrës që të aplikojnë për të përfituar subvencione, të përfitojnë fidanë, lopë dhe të tjera që ndihmojnë veprimtarinë e rregullt të buqëve.

#### **7.Dëgjimet Buxhetore me OJQ-të rinore, femrat dhe komunitetet, Datë: 07.09.2017, ora 13:00**

Disa nga komentet, kërkesat e pjesëmarrësve në takime ishin:

Shtëpia e Sigurt – që aktualisht financohet nga Qeveria mirëpo ndihmohet edhe nga Komuna, të vazhdojë të financohet edhe në vitet në vijim për shkak që numri i viktimave që Shtëpia e Sigurtë mbulon veçse po rritet. Në kuadër të projektit “Revitalizimi i Qendrave Rinore” të përfshihet edhe UMICA për shkak që nuk është e rinovuar dhe nuk ka kushte të përshtatshme për të vepruar.

Të rritet buxheti i paraparë për “Revitalizimin e Qendrave Rinore” pasi që sipas pjesëmarrësve në këtë dëgjim ishin të pa mjaftueshme 10,000.00 € të ndara për vitin 2018.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z. Shala iu lut të pranishmëve që të përcjellin thirrjet e Komunës për subvencione për OJQ-të rinorë, pasi që Komuna gjatë kësaj qeverisje ka ofruar si asnjëherë më parë subvencione dhe grante. Drejtori i Bujqësisë z. Bekim Ermeni njoftoi pjesëmarrësit mbi aktivitet që kjo drejtori parasheh të mbajë pjesën e mbetur të vitit. z. Ermeni potencoi dhe bëri thirrje për banorët pjesëmarrës që të aplikojnë për të përfituar subvencione, të përfitojnë fidanë, lopë dhe të tjera që ndihmojnë veprimtarinë e rregullt të buqëve.

## **8.Dëgjimet Buxhetore me Publikun në Lipovec,**

**Datë: 07.09.2017, ora 16:00**

### **Banorët e Lipovecit kërkuar që :**

Të shtrohet me zhavorr rruga në lagjen "Kastrati" (500 metra) pasi që është rrugë e pa kalueshme nga këmbësorët. Kërkuar urën – mbi kalim për nxënës.

Të rregullohet ndriçimi publik tek Lagjja "Ademi" pasi që shtyllat elektrike janë të zbrazëta, gjithashtu ata kërkuar që edhe lagjia "Leniqi" të përfshihet në listën e projekteve.

Banorët e rajonit kërkuar që në Demjan asnjë projekt nuk është paraparë në listën e projekteve kapitale për vitet e ardhshme, ndërkaq nevojat e banorëve janë të shumta e sidomos në pjesën e rrugës tek shkolla ku rrezikohet jeta e fëmijëve gjatë lëvizjes. Ata për më tepër thanë që ka reduktime të shumta në ujë dhe në energji elektrike. Drejtori Teki Shala ua potencoi pjesëmarrësve që është në dijeni që Demjani ka mbetur keq dhe për këtë arsye Ministria ka dhënë mjete financiare mirëpo firma nuk po mund të operojë dhe kjo është si rezultat i vetë pengesave që kanë ngritur banorët e fshatit, me kërkesat e tyre shpesh banale në momentin e operimit të firmës, z.Shala iu lut pjesëmarrësve që të mos e pengojnë firmën për të vepruar. Z. Shala tha që edhe ura tek përroi për të lëvizur nxënësit do të bëhet, pasi që procedurat janë përfunduar vetëm do të ekzekutohet si projekt, më tepër potencoi që Rruga që lidhet me Pnish do të procedohet si projekt pasi që veqse është nënshkruar kontrata. Banorët e rajonit të Lipovecit nuk u ndalën me kërkesa, kërkesat e tyre përkisnin kryesisht me infrastrukturën rrugore, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa theksoi më tutje që buxheti është i kufizuar dhe me buxhetin që kanë po përpiqen në mënyrë proporcionale të ndajnë projekte dhe shumë gjëra nuk varen nga Komuna por varen edhe nga Ministrinë përkatëse. Përveç tjerash Drejtori i Bujqësisë z. Bekim Ermeni që i njoftoi banorët lidhur me projektet e Drejtorisë së Bujqësisë duke iu bërë të ditur që Kanalin e Ujit të Gërqinës mund ta konsiderojnë si një projekt të përfunduar pasi që operatori – firma e ka urdhëresën për të vepruar mirëpo për shkak të aktiviteteve të shumta që ka firma nuk mund të fillojë njëherë me punime.

Z. Ermeni i njoftoi pjesëmarrësit mbi aktivitet që kjo drejtori parasheh të mbajë pjesën e mbetur të vitit. z. Ermeni potencoi dhe bëri thirrje për banorët pjesëmarrës që të aplikojnë për të përfituar subvencione, të përfitojnë fidanë, lopë dhe të tjera që ndihmojnë veprimtarinë e rregullt të bujqëve.

## **9.Dëgjimet Buxhetore me Publikun në Rogovë,**

**Datë: 07.09.2017, ora 18:00**

### **Banorët e Rogovës kërkuar që :**

Shtëpia e Kulturës në Rogovë të rregullohet pasi që banorët duan konkretizime, Biblioteka është poashtu një kërkesë e banorëve të rajonit të Rogovës, Kërkuar që të shtrohen policët e shtrirë në rrugë si dhe sinjalizime tjera rrugore për shkak të parandalimit të aksidenteve si rezultat i kthesave të shumta. Banorët e Rogovës kërkuar që edhe shkolla e vjetër të rinovohet, potencuan sidomos sallën e Edukatës Fizike. Gjendja me kanalizimet atmosferike nuk ishte më e mirë as në Rogovë ashtu si në shumicën e fshatrave, banorët kërkuar që të ndërmerr Komuna masa në këtë drejtim, si rezultat i ngushtimit të shtratit të ujit, këmbëza e urës është dëmtuar dhe mbushen me ujë shumë shtëpi. Kërkuar përmirësimin e shërbimeve të mirëmbajtjes publike, Patën komente edhe rreth programit të Shëndetësisë ku për fat të keq në Qendrën e tyre të Mjekësisë Familjarë mungojnë ilaçet për diabet iket dhe të sëmurët kronik. Nuk munguan as kërkesat për programin e Bujqësisë – ku banorët kërkuar ndërtimin e një Qendre Grumbulluese. Komentet e banorëve ishin nga më të ndryshmet, ku mes tjerash potencuan se vlera e ndarë prej 20,000.00 € për projektin "Ndërtimi i rrugës me kubëza në fshatin Rogovë (rruga "4 qershori 1999")" është vlerë e ulët që i ndahet Rogovës për 3 vite. Drejtorët e Drejtorive përkatëse iu përgjigjen pjesëmarrësve që: Kanalizimi i ujërave të zeza do vlerësohen nga Komuna si projekt, Do të bëhet ndërtimi i Qendrës Grumbulluese në Rogovë, Për mirëmbajtje publike duhet të bëhet një shkresë nga komuniteti, Ura, sanimi, riparimi i saj do futet në plan si pjesë e projektit "Ndërtimi dhe sanimi i urave". Përveç tjerash Drejtori i Bujqësisë z. Bekim Ermeni njoftoi pjesëmarrësit mbi

aktivitet që kjo drejtori parasheh të mbajë pjesën e mbetur të vitit. z. Ermeni potencoi dhe bëri thirrje për banorët pjesëmarrës që të aplikojnë për të përfituar subvencione, të përfitojnë fidane, lopë dhe të tjera që ndihmojnë veprimtarinë e rregullt të buqëve.

**10. Dëgjimet Buxhetore me Publikun në Mëhallë të Sefës, Datë: 08.09.2017, ora 16:00**  
**Banorët e Mëhallës së Sefës kërkuan që :**

Të realizohet projekti i rrugës “Emine Gjakova” si dhe të rregullohet kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferik në rrugën “Lekë Dukagjini”.

Drejtorët pjesëmarrës iu potencuan këtyre banorëve që rruga “Emine Gjakova” veçse do të realizohet në vitin 2018 pasi që është e inkuorporuar në aneksin e projekteve kapitale “ndërtimi i rrugëve me Kubëza”. Përveç tjerash Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik znj. Silvana Domi i njoftoi të pranishmit mbi grantet për biznese që ofron Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, potencoi që një ndër kriteret e thirrjes për aplikim për grante është pikërisht favorizimi i radhëve të komuniteteve, femrave dhe të rinjëve. Drejtori i Bujqësisë z. Bekim Ermeni njoftoi pjesëmarrësit mbi aktivitet që kjo drejtori parasheh të mbajë pjesën e mbetur të vitit. z. Ermeni potencoi dhe bëri thirrje për banorët pjesëmarrës që të aplikojnë për të përfituar subvencione, të përfitojnë fidanë, lopë dhe të tjera që ndihmojnë veprimtarinë e rregullt të buqëve. Fjalën e morri edhe Kryesuesi i Asamblesë Komunale – z. Luan Gola që falënderoi banorët e këtij rajoni që ishin pjesëmarrës në këtë dëgjim buxhetor dhe ju sqaroi se nuk ka qenë e mundur që të realizohet deri tash rruga “Emine Gjakova” sepse nuk ka qenë e paraparë për shkak që Komuna ka trashëguar shumë borxhe nga qeverisja e kaluar dhe ka marr shumë kohë dhe mjete financiare mbulimi i këtyre borxheve.

**11. Dëgjimet Buxhetore me Publikun në Gjakovë, Datë: 11.09.2017, ora 10:00**

Mbledhjen e udhëhoqi: Luan Gola – Kryesues i Kuvendit Komunal të Gjakovës, tregoi që ky dëgjim publik buxhetor është i fundit dhe përmbyllës për planifikimin e buxhetit të 3 viteve të ardhshme, theksoi se pas këtij dëgjimi publik buxheti do miratohet në Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe më pas në Asamblenë Komunale. Pas kryesuesit fjalën e morri Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Teki Shala i cili e filloi diskutimin dhe prezantoi Buxhetin Komunal për vitet 2018 – 2020, ku konstatoi së planifikimi i buxhetit është në përputhshmëri me Qarkoren e Parë Buxhetore 2018/01 dhe 2018/02 të pranuar nga MF-ve. Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa - Teki Shala theksoi se buxheti i paraparë për Komunën e Gjakovës për vitin 2018 është 22,797,637.00 € që nënkupton se ka rritje në vlerën prej 1,567,788.00 € krahasuar me vitin aktual 2017. Teki Shala potencoi burimet e financimit si dhe pjesëmarrjen e secilës kategori të shpenzimeve në buxhetin e planifikuar. Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa prezantoi tek të pranishmit edhe listën e projekteve kapitale të planifikuara për vitet 2018 – 2020. Mes tjerash ai theksoi se Komuna e Gjakovës parasheh rritje edhe tek investimet kapitale nga 5,429,406.00 € që ishin të parapara në vitin 2017, në 6,535,244.00 € për vitin 2018. Kjo rritje parashihet të vazhdojë në mënyrë progresive edhe për gjatë viteve 2019 dhe 2020.

Drejtori z. Teki Shala theksoi që deri më tash përveç se janë drejtuar në investime kapitale, Komuna e Gjakovës ka trashëguar edhe borxhe nga qeverisja e kaluar në vlerën mbi 6 milion €uro, të cilat tash janë minimizuar.

Armend Vokshi – Nënkryetari i Komunës gjithashtu e morri fjalën dhe i falënderoi të pranishmit që u treguan të kujdesshëm dhe morën pjesë në këtë dëgjim publik dhe i luti ata që të paraqesin kërkesa sa më konkrete, pasi që ka mjaftueshëm raste që kërkesat e arsyeshme që dalin nga dëgjimet buxhetore futen në listë të projekteve dhe merren për bazë gjatë planifikimit të buxhetit.

### **Pjesëmarrësit në këtë dëgjim buxhetor kërkuan që:**

Të parashihen mjete për kanalizime pasi që fshati Bërbaj, fshati Stubëll dhe fshati Morinë kanë probleme me kanalizime, Kërkuan që të parashihen mjete më shumë për Bujqësi pasi që nevojat e fshatrave janë më të mëdha se mjetet e parapara, Kërkuan më shumë mjete edhe për Shëndetësi pasi që institucionet shëndetësore nuk kanë ilaqe për pacientët e sëmurë me sëmundje të ndryshme. Kërkuan që të ndërtohen rrugët në fshatin Demjan dhe bënë kërkesa që të realizohen ato projekte ku kanë participuar qytetarët. Që të mirëmbahet lumi "Krena" dhe të rritet siguria aty, pasi që gjendja është e mjerueshme. Drejtorët e linjave përkatëse potencuan që në Demjan do të ndërtohen rrugët, dhe realizimi i tyre është përgjegjësi e Ministrisë, potencuan që me këtë qeverisje është ndaluar participimi i qytetarëve në projekte, pasi që Komuna do e realizojë në total projektin dhe nuk do e ngarkojë qytetarin. Kështu që edhe pse kanë participuar qytetarët në të kaluarën paratë nuk do humbin mirëpo varësisht nga prioritet që cakton Komuna do i vijë rendi secilit projekt. Edhe për lumin Krena drejtorët lutën qytetarët që vetë të mos hidhen mbeturina.

### **RAPORT PËRMBLEDHËS:**

Drejtorët e pranishëm mbajtën shënime sipas kërkesave të banorëve dhe sipas komenteve e ankesave të banorëve të të gjitha rajoneve.

Nga kërkesat e të gjithë rajoneve ato më të arsyeshmet, të cilat do të mirren në konsideratë apo janë përfshirë gjatë planifikimit të projekteve kapitale për vitin 2018 radhiten si më poshtë:

1. Të parashihen investime në Osek Hylë – të futet ky rajon në listë të projekteve kapitale – Kërkesë e Rajonit të Skivjanit,
2. Së shpejti do fillojnë edhe punimet në rrugën Skivjan – Novosellë pasi që është projekt që financohet nga Ministria e Infrastrukturës - Kërkesë e Rajonit të Skivjanit,
3. Projekti i Renovimit të Objekteve Shëndetësore, do të merret në Konsideratë edhe qendra e mjekësisë familjare e rajonit të Becit.
4. Ura tek përroi për të lëvizur nxënësit do të bëhet, pasi që procedurat janë përfunduar vetëm do të ekzekutohet si projekt - Kërkesë e Rajonit të Lipovecit,
5. Rruga që lidhet me Pnish do të procedohet si projekt pasi që veçse është nënshkruar kontrata - Kërkesë e Rajonit të Lipovecit,
6. Kanalin e Ujitjes të Gërçinës mund ta konsiderojnë si një projekt të përfunduar pasi që operatori – firma e ka urdhëresën për të vepruar mirëpo për shkak të aktiviteteve të shumta që ka firma nuk mund të fillojë njëherë me punime - Kërkesë e Rajonit të Lipovecit,
7. Kanalizimi i ujërave të zeza do vlerësohen nga Komuna si projekt - Kërkesë e Rajonit të Rogovës,
8. Do të bëhet ndërtimi i Qendrës Grumbulluese në Rogovë - Kërkesë e Rajonit të Rogovës,
9. Për mirëmbajtje publike duhet të bëhet një shkresë nga komuniteti, Ura, sanimi, riparimi i saj do futet në plan si pjesë e projektit "Ndërtimi dhe sanimi i urave" - Kërkesë e Rajonit të Rogovës,
10. Do të realizohet projekti i rrugës "Emine Gjakova" si dhe të rregullohet kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferik në rrugën "Lekë Dukagjini" - Kërkesë e Mëhallës së Sefës.
11. Në Demjan do të ndërtohen rrugët dhe realizimi i tyre është përgjegjësi e Ministrisë.